



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 8104

Tirane, date 15.12.2014

Drejtuar: ZOTIT KORAY ZEYTIOGLU
SHOQERIA "KURUM INTERNATIONAL" SH.A
BULEVARDI DESHMORET E KOMBIT, KULLAT BINJAKE K10/2
TIRANE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"
TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE
TIRANE

Z. ARDIAN MAÇI, DREJTOR I PERGJITHSHEM
QENRA KOMBETARE E LICENCIMIT
TIRANE

Lënda: Njoftim mbi fillimin e procedurave te revokimin e lejes nr.1307 date 28.01.2009.

I nderuar zoti Zeytioglu,

Shoqëria "Kurum International" sh.a është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1307 date 28.01.2009, për mineral hekuri-nikeli, ne Prrrenjas, Librazhd te Qarkut te Elbasanit.

Nga struktura përgjegjëse AKBN, ne raportimet vjetore qe janë dërguar për vitet 2010, 2011 dhe 2013, është thënë se shoqëria juaj nuk ka plotësuar detyrimet qe përcaktohen ne nenin 18 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar dhe propozohet për revokimin e lejes ne fjale. Nga AKBN-ja është përsëritur propozimi për revokimin e lejes nr.1307 date 28.01.2009, me shkresën nr.8157 date 07.09.2015 e shkresën nr.9803 date 16.11.2015 protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) respektivisht me nr.6025 date 08.09.2015 dhe nr.7511 date 17.11.2015.

Propozimi i AKBN-se është i mbështetur ne piken nr.1 te nenit 47 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", konkretisht shkronja "b" paragrafi ii, per mos fillim pune për 180 dite kalendrike nga date e miratimit te lejes dhe, germën "ç" mos kryerjen e pagesave te garancive financiare për vitin 2013-2014, vitin 2014-2015, vitin 2015-2016, qe janë shkaqe ligjore qe bëjnë revokimin e lejes.

Shoqërisë i është dërguar njoftimi nr.3401 date 09.04.2012 nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) aktualisht Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI) "Njoftim mbi revokimin e lejes minerare nr.1307 date 28.01.2009" që ka qene njoftim që lidhej me fillimin e procedurave të revokimit të lejes, që ju zotëroni për mineral hekur-nikeli në ish minierën e Prrenjasit. Është përsëritur ky njoftim me shkresën tone nr.7007 date 27.11.2014. Këto procedura kanë ngelur të papërfunduara sipas akteve ligjore që rregullojnë veprimtari të minerare, por edhe nga ana juaj si shoqëri zotëruese të lejes nuk ka pasur asnjë reagim për shkeljet ligjore që cituam më lart.

Sa më sipër, në zbatim të pikave 1 dhe 2 të nenit 48 të ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë", ju njoftojmë se kanë rifilluar procedura e revokimit të lejes nr.1307 date 28.01.2004.

Ju bëjmë me dije se brenda një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do merret vendimi për revokimin e lejes minerare në fjale.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë" zotëruesi i lejes detyrohet të zbatojë planin e rehabilitimit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

